



PLANI LOKAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË



KOMUNA E
HANIT TË ELEZIT

Implementuar nga:

UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:

**SWEDISH DEVELOPMENT
COOPERATION**



Shembulli i Komunes së Hanit të Elezit

PLANI LOKAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Korrik 2014

PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË



KOMUNA E
HANIT TË ELEZIT

Implementuar nga:

UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:

**SWEDISH DEVELOPMENT
COOPERATION**



Plani Lokal për Menaxhimin e Mbeturive në Komunën e Hanit të Elezit 2014 – 2019 është hartuar nga Programi për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë i cili implementohet nga UN Habitat-i dhe financohet nga Swedish Development Cooperation; së bashku me Komunën e Hanit të Elezit, respektivisht Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës. Ky dokument është revidim i Planit për Menaxhim të Qëndrueshëm Të Mbeturive të Ngurta për Komunën e Hanit të Elezit 2011-2015. Drafti përfundimtar i këtij dokumenti është përgatitur në Korrik 2014.

Përmbajtja

Shkurtesat	iii
I. Hyrja dhe historiku.....	1
1.1 Situata aktuale në menaxhimin e mbeturinave	1
1.1.1 Komuna e Hanit të Elezit.....	1
1.1.2 Sasia dhe përbërja e mbeturinave	3
1.1.3 Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave dhe metodat e deponimit	4
1.1.4 Ndarja, kompostimi dhe riciklimi i mbeturinave.....	5
1.1.5 Aspekti organizativ dhe financiar i menaxhimit aktual të mbeturinave	5
1.2 Përmbajtja dhe Zhvillimi i Planit të Menaxhimit të Mbeturinave	6
II. Objektivat.....	7
III. Masat për përmirësim	8
3.1 Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.....	8
3.2 Promovimi i kompostimit.....	8
3.3 Prezantimi i riciklimit	9
3.4 Eliminimi i deponive të paligjshme të mbeturinave	9
3.5 Menaxhimi i mbeturinave të ndërtimit	10
3.6 Pastrimi i rrugëve	10
IV. Financimi i menaxhimit të mbeturinave	11
4.1 Tarifat e mbeturinave	11
4.2 Mbështetja nga buxheti komunal.....	11
V. Masat mbështetëse	13
5.1 Ngritja e vetëdijes së publikut.....	13
5.2 Programet e trajnimit	13
VI. Rregulloret dhe zbatimi.....	14
6.1 Rishikimi i rregulloreve të menaxhimit të mbeturinave.....	14
6.2 Zbatimi	14
Shtojca I. Anëtarët e Grupit Punues për Përgatitjen e Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave	15
Shtojca II. Plani i Veprimit.....	16
Përmbledhje e kostos në vit për secilin aktivitet	21
Shtojca III. Të dhënat për mbeturinat e Sharrcem-it.....	22

Lista e tabelave

Tabela 1.1.1 Numri i popullsisë për vendbanime	2
Tabela 1.1.2 Sasia e mbeturinave të gjeneruara.....	3
Tabela 1.1.3 Përbërja e mbeturinave të amvisërisë në Kosovë dhe Han të Elezit.....	4
Tabela 1.1.4 Metodatat e tanishme të deponimit.....	5
Tabela 3.1.1 Orari i propozuar i mbledhjes së mbeturinave në Han të Elezit.....	8

Lista e hartave

Harta 1.1.1 Lokacioni i Hanit të Elezit.....	2
--	---

Shkurtesat

AKS	Agjencia Kosovare e Statistikave
AKMM	Agjencia Kosovare për mbrojtjen e mjedisit
KB	Kombet e Bashkuara
KK	Kuvendi Komunal
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MMNG	Menaxhimi i mbeturinave të ngurta komunale
MN&D	Mbeturinat nga Ndërtimi dhe Demolimi
MNK	Mbeturinat e ngurta komunale
MuSPP	Programi për mbështetjen e planifikimit hapësinor komunal
OBSH	Organizata botërore e shëndetësisë
OJQ	Organizatat jo qeveritare
PLVM	Plani Lokal i Veprimit Mjedisor
PLMMN	Plani lokal i menaxhimit të mbeturinave të ngurta
SIDA	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim
TeR	Termet e Referencës
UNDP	Programi për zhvillim i kombeve të bashkuara
UN-Habitat	Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanim Njerëzor
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor

I. Hyrja dhe historiku

1.1 Situata aktuale në menaxhimin e mbeturive

1.1.1 Komuna e Hanit të Elezit

Komuna e Hanit të Elezit gjendet në pjesën juglindore të Kosovës. Ajo kufizohet me komunën e Kaçanikut në veri dhe me Republikën e Maqedonisë në perëndim, lindje dhe jug. Ajo ndodhet, në mes të maleve të Sharrit në perëndim dhe maleve të Karadakut në lindje, përgjatë rrugës kryesore Prishtinë-Shkup e cila të shpjen për në Maqedoni. Territori i Hanit të Elezit ka një sipërfaqe prej përafërsisht 82.95 km² ose 8294.37.53 ha (0.77% të territorit të Kosovës).

Komuna përfshin qytetin e Hanit të Elezit dhe dhjetë vendbanime: Krivenik, Gorance, Rezhancë, Pustenic, Paldenicë, Secishtë, Dimçe, Dremjak, Neqafç dhe Vertomicë. Vendbanimet janë të shpërndara në të dy anët e qytetit dhe në të dy anët e lumit Lepenc. Vendbanimet janë të lidhura me qytetin me rrugë, shumica e të cilave janë të shtruara. Disa rrugë janë të pashtuara ose me zhavorr.

Harta 1.1.1 Lokacioni i Hanit të Elezit



Burimi: *Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2010-2025*

Hani i Elezit është i vendosur në një rajon malor që karakterizohet nga vegetacioni bimor dhe drusor i mbizotëruar nga bingu. Shpatet e ekspozuara në drejtim të jugut absorbojnë më shumë energji diellore, duke krijuar një klimë të ngrohtë dhe duke shkrirë borën më shpejtë. Këto kushte janë ideale për kultivimin e vegetacionit. Në krahasim, ana veriore e kodrave mbetet kryesisht e mbuluar me borë deri në fund të pranverës.

Në Komunën e Hanit të Elezit, klima është e ngrohtë dhe e butë. Temperatura mesatare vjetore është 11.6°C. Muaji më i ngrohtë i vitit është gushti me një temperaturë mesatare prej 21.7°C. Në janar, temperatura mesatare është 0.2 °C. Reshjet mesatare vjetore janë 618 mm.

Në vitin 2011 Hani i Elezit kishte një popullsi prej 9.395 banorë (Regjistrimi i popullsisë 2011) të cilët janë kryesisht shqiptar të Kosovës. Ka 35 boshnjakë të Kosovës që jetojnë në Hanin e Elezit. Popullsia e komunës është e re ku 30% e popullsisë është nën moshën 15 vjeçare dhe vetëm 5% mbi moshën 65 vjeçare. Rreth 15% e popullsisë konsiderohet se jetojnë në varfëri të skajshme, ndërsa rreth 37% mund të konsiderohen si të varfër (Banka Botërore).

Tabela 1.1.1 Numri i popullsisë për vendbanime

Vendbanimi	Popullata (2011)	Vendbanimi	Popullata (2011)
Hani I Elezit (Qyteti)	2.534	Neçavc	110
Dimcë	249	Paldenicë	1.723
Dramjak	121	Pustenik	615
Gorancë	1.028	Rezhancë	475
Krivenik	289	Seçishtë	2.251
Vërtomicë	0	Hani i Elezit (totali)	9.395

Burimi: Raportet e regjistrimit të popullsisë 2011 – AKS

Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit përfshin një parashikim të popullsisë për vitin 2025. Duke përfshirë ata të regjistruar por jo që jetojnë në Han të Elezit, pritet të ketë një popullsi prej 11.860 banorëve. Me 12% të popullsisë që jetojnë jashtë Kosovës, numri i banorëve të përhershëm (duke përfshirë diasporën) do të jetë rreth 10.440 banorëve. Në bazë të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 dhe parashikimin, numri aktual (2014) i banorëve të përhershëm mund të llogaritet të jetë rreth 9.600 banorë.

Industria është mjaft e zhvilluar në Hanin e Elezit dhe e njohur mirë jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë. Kompania më e rëndësishme industriale është fabrika e çimentos Sharrcem e cila punëson mbi 500 punonjës. Kompani tjera kryesore janë Kosovaplast, e cila është një kompani private për prodhimin e stiroporit, dhe Sharr Sallonit, një fabrikë tani e privatizuar që përdoret për prodhimin e asbestit për artikuj të çimentos, por ambientet e saj janë duke u përdorur si Terminal Doganor. Struktura e tanishme e biznesit në Han të Elezit është si më poshtë:

- Tregti 47 subjekte
- Shërbime Hoteliere (hotele, furnizim ushqimi, kafiteri / bare, etj) 22 subjekte
- Prodhim 4 subjekte
- Transport 55 biznese me një total prej mbi 100 kamionë të ndryshëm për transport
- Ndërtimtari 5 subjekte
- Transport mallrash 58 kompani
- Shërbime 21 subjekte
- Zejtari 7 subjekte

Gjithashtu ka disa sipërmarrës joformal, të përgjithshme si elektrikistë, kompani ndërtimore, frizer, rrobaqepës etj.

Institucionet brenda komunës përfshijnë:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)
- Ndërtesa e Komunës
- Shkolla fillore me paralele të ndara në katër fshatrat të vogla
- Dy shkolla fillore të fshatit (në Paldenicë dhe Gorancë)
- Stacioni Policor
- Zyra postare
- Stacioni i trenit me pikë doganore
- Stacioni i zjarfikësve

- Pika Kufitare

1.1.2 Sasia dhe përbërja e mbeturinave

Llojet dhe sasinë e mbeturinave - Nuk ka të dhëna zyrtare mbi sasinë dhe përbërjen e mbeturinave të grumbulluara. Megjithatë, në vitin 2011, është kryer një analizë e mostrave të mbeturinave dhe janë mbledhur të dhëna mbi gjenerimin e mbeturinave. Bazuar në të dhënat, gjenerimi i përditshëm i mbeturinave për person në komunë është vlerësuar të jetë 0.25 kg/person. Me 9600 banorë të përhershëm, gjenerimi vjetor i mbeturinave të amvisërisë mund të vlerësohet të jetë rreth 875 ton.

Mbeturinat e ngurta komunale përfshijnë mbeturinat komerciale krahas mbeturinave të amvisërisë. Një supozim është se mbeturinat e amvisërisë përbëjnë vetëm 70% deri 75% të totalit të mbeturinave të ngurta komunale. Krahas përafërsisht 850 ton të mbeturinave të amvisërisë, janë deri në 375 ton mbeturina komerciale që pritet që të gjenerohen.

Përveç të dhënave të grumbulluara gjatë marrjes dhe analizës së mostrave të mbeturinave të vitit 2011, po ashtu është në dispozicion informacioni mbi sasinë e mbeturinave të dërguara në stacionin e transferimit në Ferizaj dhe më pastaj në deponinë e mbeturinave në Gjilan. Ky informacion tregon se rreth 900 ton mbeturina në vit grumbullohen në Han të Elezit. Edhe pse, shërbimet e grumbullimit të mbeturinave ofrohen tek shumica e gjeneruesve të mbeturinave, shërbimet e grumbullimit të mbeturinave nuk janë gjithmonë të besueshme dhe disa fshatra¹ nuk marrin fare shërbime të grumbullimit të mbeturinave (referohuni seksionit 1.1.3). 900 ton të mbeturinave të mbledhura në një bazë vjetore përfaqëson rreth 75% të mbeturinave të gjeneruara. Kjo do të tregonte një gjenerim vjetor të mbeturinave prej 1200 ton.

Për qëllime të planifikimit, bazuar në ato që u than më sipër, do të supozohet se do të gjenerohen nga 1200 deri në 1300 ton mbeturina të ngurta komunale në vit.

Përveç mbeturinave shtëpiake dhe komerciale, po ashtu gjenerohen mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi në Han të Elezit. Informacioni i besueshëm nuk është në dispozicion, por vëzhgimet e bëra në deponi, ku mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimin përdoren për ngritjen e terrenit si përgatitjet për realizimin e një parku, tregojnë se norma e gjenerimit mund të jetë prej disa në qindra ton në vit. Kjo shumë nuk përfshin mbeturinat e rrënimin të gjeneruar nga fabrika e çimentos.

Edhe pse në Han të Elezit ka disa kompani industriale, mbetjet industriale praktikisht nuk gjenerohen. Kompania e çimentos dhe kompania që prodhon stiropol, praktikisht ri-përdorin të gjitha mbeturinat e tyre në proceset e tyre të prodhimit. Për më tepër, fabrika e çimentos përdor mbeturina industriale nga gjeneratorët tjera të mbeturinave si lëndë të parë për prodhimin e çimentos. Si shembull mund të përmendet shfrytëzimi i hirit nga sektori i prodhimit të energjisë elektrike. Fabrika e çimentos megjithatë gjeneron mbeturina të krahasueshme me ato të amvisërisë si dhe mbeturina nga shkatërrimi i ndërtesave të vjetra të fabrikës. Një pasqyrë e gjenerimit të mbeturinave dhe shfrytëzimin nga ana e fabrikës së çimentos është përfshirë si shtojca 3.

Tabela 1.1.2 Sasia e mbeturinave të gjeneruara

Lloji i mbeturinave	Gjenerimi i sasisë së mbeturinave (vlerësim)
Mbeturinat shtëpiake	875 ton/vit
Mbeturinat komerciale	375 ton/vit
Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi	200 to 500 ton/vit
Mbeturinat industriale (mbeturinat nga Sharrcem)	1,650 ton në vitin 2013 (përfshirë 885 ton mbeturina nga rrënimi, 308 ton metale nga rrënimet dhe 330 ton tulla rezistues ndaj nxehtësisë për ripërdorim në prodhimin

¹ Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave nuk janë në dispozicion në Dimçë, Gorance, Krivenik dhe Rezhance, fshatra me respektivisht 30, 160, 40 dhe 30 amvisëri.

	e çimentos)
--	-------------

Burimi: Plani i mëparshëm i Menaxhimit të Mbeturinave të HiE dhe burimet komunale

Përbërja e mbeturinave - Përbërja e mbeturinave shtëpiake është përcaktuar në detaje gjatë elaborimit të Planit për Menaxhimin e Qëndrueshëm të mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit në vitin 2011. Tabela në vijim tregon përbërjen e mbeturinave në Hanin e Elezit në kategori të përcaktuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe krahason përqindjet e të dhënave në Kosovë të raportuara në "Situatën e tanishme të mbeturinave në Kosovë, 2008", publikuar nga Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit.

Tabela 1.1.3 Përbërja e mbeturinave të amvisërisë në Kosovë dhe Han të Elezit

Ndarja e mbeturinave	Kosovë	Hani i Elezit
Organike (mbeturinat e kuzhinës dhe kopshtit)	35.3%	35.8%
Çelçi	21%	11.8%
Druri	11%	14.2%
Plastika	9.4%	9.4%
Metalet	9.3%	11.1%
Tekstilet	8.2%	13.5%
Letër dhe karton	4.6%	4.1%
Mbeturinat e rrezikshme shtëpiake	1.2%	0.1%
	100%	100%

Burimi: Plani i mëparshëm i Menaxhimit të Mbeturinave të HiE dhe "Gjendja e Tanishme e Mbeturinave në Kosovë" - AKMM

Duke i krahasuar me mbeturinat e amvisërisë, mbeturinat komerciale do të përmbajnë përqindje më të lartë të materialeve të paketimit dhe në këtë mënyrë përqindje më të lartë të letrës, kartonit dhe plastikes. Përveç kësaj, mbeturinat komerciale përmbajnë mbeturina (nën-produkte të kafshëve) nga thertoret.

Përbërja e mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimin nuk është hulumtuar. Vëzhgimet në deponi megjithatë tregojnë se pjesa më e madhe e mbeturinave janë: betoni dhe tullat e rrënojes. Fraksionet e ndryshme që përbëjnë mbeturinat e gjeneruara nga industria (Sharrcem) janë paraqitur në shtojcën 3.

1.1.3 Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave dhe metodat e deponimit

Shërbimet aktuale të menaxhimit të mbeturinave ofrohen nga kompania "PASTËRTIA". Kompania është në pronësi private dhe është e kontraktuar nga Komuna për të ofruar shërbime. Kompania ka 7 punonjës me orar të plotë që përfshijnë: një drejtor, një shofer dhe dy punëtorë përcjellës të automjetit për mbledhje të mbeturinave, një pastrues rrugësh, një inkasant dhe një person në gatishmëri për të ndihmuar kudo që nevojitet.

Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave ofrohen praktikisht për gjithë gjeneruesit e mbeturinave në komunë. Në qendrën e qytetit, dy herë në javë kryhet shërbimi, ndërsa në zonat tjera të banimit, shërbimi kryhet një herë në javë. Shërbimi, parimisht, kryhet gjatë katër ditëve të grumbullimit. Nuk grumbullohen mbeturinat të hënave, të preteve dhe të dielave. Megjithatë, automjeti i vetëm për mbledhjen e mbeturinave që përdoret për grumbullimin e mbeturinave është i vjetër (i prodhuar në vitin 2001), dhe nuk është më i besueshëm. Shërbimi nuk mund të kryhet në rrugët e pjerrëta malore dhe në disa fshatra (Dimce, Gorancë, Krivenik dhe Rezhancë). Dëmtimet e automjeteve do të thotë se jo të gjitha mbledhjet e planifikuara të mbeturinave mund të kryhen. Këto arsye të kombinuara bëjnë që rreth 20% ose më shumë të mbeturinave të krijuara të mos mund të mblidhen.

Gjeneratorët e mbeturinave përdorin kontejnerë të mbeturinave me rrota për mënjanimin e mbeturinave të tyre. Të gjitha amvisëritë janë pajisur me një kontejner me rrota të mbeturinave prej 120 litrave ndërsa bizneset dhe institucionet përdorin kontejner çeliku ose plastike prej 1,100 litrave.

Mbeturinat e mbledhura transportohen në stacionin e transferimit në Ferizaj (20 km nga Hani i Elezit) ose direkt në deponi në Gjilan, e cila është pak më shumë se 60 km larg. Edhe pse më larg, transportit në deponi është i preferuar sepse shkarkimi i lehtë dhe i menjëhershëm i mbeturinave është i garantuar, ndërsa stacioni i transferimit shpesh është i stërmbushur. Në stacionin e transferimit dhe në deponi, ngarkesa e mbeturinave duke përfshirë mbeturinat e kafshëve herë pas here refuzohen ose pranohen vetëm me një pagese më të lartë për deponim.

Përveç grumbullimit të mbeturinave, kompania ofron shërbimin për pastrimin e rrugëve dhe parqeve dhe, sipas nevojës, ofron shërbimet e riparimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi menaxhohen nga vet gjeneratorët e mbeturinave. Me rimorkio të kamionit ose traktorit, gjeneratorët e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitit transportojnë mbeturinave në një deponi përgjatë lumit Lepenc në pjesën veriore të komunës. Aty mbeturinat përdoren për të mbushur gropat e erozionit si përgatitje për realizimin e një parku përgjatë lumit. Mbikëqyrja e deponisë është shumë e kufizuar dhe herë pas here deponohen edhe mbeturina tjera përveç atyre të ndërtimit dhe rrënitit. Për më tepër, për shkak të mungesës së mbikëqyrjes, nuk verifikohet cilësia dhe pranueshmëria e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitit.

Mbeturinat e gjeneruara nga fabrika e çimentos Sharrcem, e cila nuk shfrytëzohet përsëri në procesin e prodhimit apo shitet direkt, mbledhet kryesisht nga një kompani private e mbeturinave nga Ferizaj. Mbeturinat e përziera të krahasueshme me ato të amvisërisë transportohen në deponinë e Gjilanit ndërsa pjesët e ndara riciklohen. Me shpenzime të Sharrcem-it, kompania nga Ferizaji gjithashtu zbraz kontejnerët që gjenden jashtë fabrikës së çimentos përgjatë rrugës që shpie në kufi me Maqedoninë. Siç u përmend, sasi të mëdha të mbeturinave, të tilla si tulla rezistuese ndaj zjarrit, mbahen në fabrikën e çimentos në mënyrë që të përdoren si lëndë e parë në procesin e prodhimit të çimentos.

Tabela 1.1.4 metodat e tanishme të deponimit

Lloji i mbeturinave	Sasia (t/vit)	Metoda e deponimit
Mbeturinat e amvisërisë	660	Hidhen në deponi jashtë komunës
Mbeturinat e amvisërisë	215	Hidhen në deponi në komunë
Mbeturinat komerciale	280	Hidhen në deponi jashtë komunës
Mbeturinat komerciale	95	Hidhen në deponi në komunë
Mbeturinat e ndërtimit	200 to 500	Hidhen në deponi në komunë
Mbeturinat industriale	1300	Hidhen ose shiten jashtë komunës
Mbeturinat industriale	330	Mbahen në vend dhe përdoren si lëndë e parë

Burimi: Plani i mëparshëm i Menaxhimit të Mbeturinave të HiE dhe burimet komunale

1.1.4 Ndarja, kompostimi dhe riciklimi i mbeturinave

Për momentin ndarja e mbeturinave, kompostimi ose riciklimi është duke ndodhur në Han të Elezit në një shkallë të kufizuar. Në Ferizaj, ekziston një kompani që merret me materiale të riciklueshme, por pasi që kjo kompani vazhdimisht mbyllet dhe hapet përsëri, kjo nuk garanton nisjen e grumbullimit të ndarë të fraksioneve të riciklueshme. Megjithatë, si pjesë e ISO 14001-Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit, fabrika e çimentos Sharrcem ka prezantuar ndarjen e mbeturinave në fraksione të riciklueshme të tilla si plastik dhe metale në kontejnerë specifik të mbeturinave.

Kompostimi praktikohet në komunë në një shkallë modeste. Disa individë që jetojnë në fshatra deponojnë pjesë organike të mbeturinave në vende larg nga ndërtesat e banimit së bashku me një sasi të plehut organik në mënyrë që të dekompozohen pa ndonjë vëmendje të shtuar ose trajtim. Kjo rezulton në prodhimin e një produkti kompostimi gjatë një periudhë të zgjatur kohore (disa muaj), e cila përdoret pastaj në kopshtari apo bujqësi.

1.1.5 Aspekti organizativ dhe financiar i menaxhimit aktual të mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave është përgjegjësi e Komunës së Hanit të Elezit. Për ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, Komuna ka blerë një makinë të grumbullimit të mbeturinave dhe ka ofruar kontejnerë

të mbeturinave për të gjithë gjeneratorët e mbeturinave. Për funksionimin e automjetit dhe mbledhjen e mbeturinave, komuna ka angazhuar dhe ka kontraktuar një kompani private. Kompania, "PASTERTIA", po ashtu është ngarkuar për të mbledhur tarifat e mbeturinave.

Tarifat aktuale janë:

- Amvisëritë që përdorin kontejner pre 120 litrave: 3,00 € në muaj
- Bizneset paguajnë një tarifë që varion nga 5,00 € deri 15,00 € në muaj
- Bizneset e mëdha që përdorin kontejnerët prej 1100 litrave paguajnë 12 € për shkarkim e kontejnerit ose rreth 50 € në muaj për mbledhje javore të mbeturinave apo 100 € në muaj për mbledhje dy herë në javë..

Në bazë të informacionit të dhënë nga kompania, niveli i taksave të mbledhura vlerësohet të jetë 30%.

Pagesa nga institucionet është mbi 30%. Edhe pse Komuna është pronar i automjetit të grumbullimit të mbeturinave, Komuna paguan për grumbullimin e mbeturinave nga zyrat e tyre. Përveç kësaj, komuna paguan për mbeturinat e krijuara në shkolla, në stacionin e zjarrfikësve, amvisërive dhe mbeturinat nga qendra shëndetësore². Policia, pika kufitare dhe doganore nuk paguajnë për grumbullimin e mbeturinave, ndërsa autoritetet në stacionin e trenit paguajnë.

Për deponimin e mbeturinave të grumbulluara qoftë në stacionin e transferimit ose në deponi, kompania për mbledhjen e mbeturinave paguan një tarifë prej 6 € për ton.

1.2 Përmbajtja dhe Zhvillimi i Planit të Menaxhimit të Mbeturinave

Ky plan paraqet objektivat për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Hanit të Elezit, si dhe masat që duhen ndërmarrë për t'i realizuar objektivat. Plani përfshin financimin e masave që do të merren dhe akterët përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve. Janë përshkruar masat mbështetëse si dhe rregullimin dhe zbatimin për të rritur suksesin e aktiviteteve.

Hartimi i një plani lokal për menaxhimin e mbeturinave është një detyrim ligjor për komunat e Kosovës i cila është i përcaktuar në nenin 10 të Ligjit për Mbeturina Nr 04/L-060. Gjatë hartimit të këtij plani lokal për menaxhimin e mbeturinave janë marr parasysh ligji, strategjia e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave 2012-2021 dhe Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2017.

Poashtu edhe ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (Ligji për VSM. Nr.03/L-230) është marrë në konsideratë. Megjithatë, hartimi i një raporti të VSM-së nuk do të jetë e nevojshme për këtë plan. Plani nuk përfshin ndonjë projekt, objekt ose instalim, për të cilat do të kërkohet hartimi i një Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM).

Plani aktual i menaxhimit të mbeturinave për komunën e Hanit të Elezit është i bazuar në PLANIN PËR MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË MBETURINAVE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT të vitit 2011 i hartuar nga grupi punues (referohuni Shtojcës 1) i cili në atë kohë ishte i ndihmuar nga programi LOGOS i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë. Plani është zbatuar pjesërisht me sigurimin e kontejnerëve të mbeturinave për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave në komunë dhe prokurimin e një automjeti për grumbullimin e mbeturinave si një arritje e madhe. Qëllimet tjera janë plotësuar pjesërisht apo nuk janë plotësuar. Për këtë arsye është i nevojshëm rishikimi dhe përditësimi i planit, së bashku me harmonizimin e planit me politikën qendrore dhe kornizën ligjore.

² Mbeturinat e rrezikshme shëndetësore, të tilla si mbeturinat infektive dhe të mprehta, mbledhet nga një kompani vendore e mbeturinave e specializuar në mbledhjen e këtij lloji të mbeturinave.

II. Objektivat

Qëllimi i përgjithshëm i Komunës së Hanit të Elezit është t'i ofroj banorëve të komunës një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm i cili është i lirë nga mbeturinat dhe ndikimet negative të tyre. Për të realizuar këtë qëllim të përgjithshëm, Komuna ka formuluar objektivat e mëposhtme të menaxhimit të mbeturinave për periudhën deri në vitin 2019.

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve - Komuna do të vazhdojë të përmirësoj shërbimet e grumbullimit të mbeturinave dhe synon të zgjerojë ofrimin e shërbimeve nga një mbulim prej 70% ashtu që shërbimet e grumbullimit të mbeturinave t'i ofrohen gjithë gjeneruesve të mbeturinave në komunë deri në fund të vitit 2015.

Promovimi i kompostimit - Pasi që kompostimi është duke u praktikuar në një shkallë shumë modeste dhe vetëm në fshatra, Komuna nuk dëshiron në këtë fazë të formuloj qëllime konkrete, të matshme për kompostimin e pjesës së mbeturinave organike. Megjithatë, Komuna dëshiron që të nxisë kompostimin nëpërmjet pilot projekteve demonstruese në qytetin e Hanit të Elezit sa i përket amvisërive me kopshte të mëdha.

Prezantimi i riciklimit - Komuna dëshiron të prezantoj mbledhjen e ndarë të pjesëve të riciklueshme në bazë të një sistemi të ndarjes së mbeturinave. Objektivi është në krijimin e një zonë ku gjeneruesit e mbeturinave mund t'i sjellin pjesët e mbeturinave të riciklueshme dhe ku mbeturinat e riciklueshme mund të grumbullohen deri në atë mase ku kemi një sasi të mjaftueshme për të garantuar transportimin për shitje jashtë komunës.

Eliminimi i deponive ilegale - Komuna dëshiron t'i eliminoj të gjitha deponitë e paligjshme të mbeturinave deri në 2017.

Shfrytëzimi i mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit - Komuna dëshiron të shfrytëzojë mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit si bazë për zbulimin e komunës.

Pastrimi i rrugëve - Pastrimi i rrugëve ka rëndësi të veçantë për komunën. Komuna ka për qëllim që të përmirësoj vazhdimisht pastërtinë e rrugëve dhe hapësirave publike.

III. Masat për përmirësim

3.1 Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave

Në mënyrë që të zgjerohet grumbullimi i mbeturinave nga niveli aktual i cili është 70% e grumbullimit të mbeturinave në 100% të të gjithë gjeneruesve të mbeturinave, komuna ka për qëllim që të rris efikasitetin e pajisjeve të grumbullimit të mbeturinave. Komuna synon që të prokurojë një automjet të ri apo të përdorur ne gjendje te mire për grumbullimin e mbeturinave i cili do të menaxhohet nga një kompani në pronësi komunale për menaxhimin e mbeturinave publike komunale. Në rast se Komuna dështon të siguroj miratimin nga qeveria qendrore për krijimin e një kompanie publike, automjeti për mbledhjen e mbeturinave do të menaxhohet dhe shërbimet e grumbullimit të mbeturinave do të ofrohen nga një kompani private që duhet kontraktuar.

Komuna do të mbaj automjetin e tanishëm për grumbullimin e mbeturinave i cili do të shërbejë si pajisje kujdestare që do të vihet në shërbim sa herë që automjeti që do të prokurohet apo duhet të riparohet ose për ndonjë arsye tjetër që nuk do të përdoret.

Me atë automjet për grumbullimin e mbeturinave që do të blihet (prokurohet), do të sigurohet kapaciteti për të ofruar shërbime javore të grumbullimit të mbeturinave dhe shërbimet e tilla do të ofrohen për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave nga viti 2015 e tutje. Orari i grumbullimit të mbeturinave do të përcaktohet nga Departamenti i Shërbimit Publik në konsultim me kompaninë e menaxhimit të mbeturinave publike apo private. Parapikishtë, paraqitet orari i mëposhtëm.

Tabela 3.1.1 Orar i propozuar i mbledhjes së mbeturinave në Han të Elezit

Vendbanimi	Dita(t) e grumbullimit	Vendbanimi	Dita e grumbullimit
Hani I Elezit (Qyteti)	E hënë dhe e enjte	Neçavc	E hënë
Dimcë	E hënë	Paldenicë	E enjte
Dramjak	E hënë	Pustenik	E hënë
Gorancë	E hënë	Rezhancë	E enjte
Krivenik	E hënë	Seçishtë	E hënë dhe E enjte
Vërtomicë	E hënë		

Me automjetin që do të blihet (prokurohet), shërbimet e grumbullimit të mbeturinave mund të ofrohen për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave për vetëm dy ditë të grumbullimit të mbeturinave në javë. Për të rritur përdorimin efikas të automjetit të grumbullimit të mbeturinave, Komuna synon zgjerimin e shërbimeve për gjeneruesit e mbeturinave që aktualisht kryhet nga një kompani e menaxhimit të mbeturinave nga një komunë tjetër duke përfshirë edhe fabrikën e çimentos Sharrcem.

3.2 Promovimi i kompostimit

Trajtimi i pjesëve organike të mbeturinave do të promovohet nga Komuna. Qëllimi është që praktikat aktuale në fshatra të zgjerohen në qytetin e Hanit të Elezit. Në bashkëpunim me krerët e fshatrave në Qytetin e Hanit të Elezit, do të identifikohen individë të interesuar për kompostim në shtëpi dhe këta individë do të mbështetët në ngritjen e pilot projektit për aktivitete të kompostimit në shtëpi. Për deri dhjetë familje Komuna do të sigurojë materiale për të ndërtuar kontejnerët e kompostimit, si dhe do t'i informoj me të gjitha informacionet e nevojshme për të filluar procesin e kompostimit. Nëse është e mundur, do të realizohen kontejner të ndryshëm të kompostimit si dhe kontejner komercial të postimit mund të përfshihen në aktivitete. Individët që marrin pjesë do të inkurajohen të takohen rregullisht me qëllim të shkëmbimit të përvojave të tyre.

Pjesëmarrësit e vazhdueshëm dhe të suksesshëm në skemën e kompostimit do të zvogëlojnë sasinë e mbeturinave të tyre që duhet të mbledhen dhe Komuna, pra, do t'i lejoj atyre një zbritje të tarifës së mbeturinave prej 25%.

Përveç kompostimit në shtëpi, komuna synon të hulumtoj fisibilitetin e një sistemi të centralizuar të kompostimit. Kompania përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave do të mund të shfrytëzoj një objekt të vogël kompostimi, me

teknologji jo moderne në një vend në komunë që pritet të identifikohet. Nëse është e nevojshme, vendi mund të përgatitet për aktivitetin e kompostimit duke shfrytëzuar se pari mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi (referohuni seksionit 3.5).

3.3 Prezantimi i riciklimit

Pasi që banorët e Hanit të Elezit nuk e praktikojnë ndarjen e mbeturinave në shtëpitë e tyre në këtë moment dhe aktualisht vetëm 70% e gjithë gjeneruesve të mbeturinave gëzojnë mbledhjen e mbeturinave, futja e grumbullimit të veçantë, të pjesëve të mbeturinave të riciklueshme nga mjediset e gjeneruesve të mbeturinave, nuk konsiderohet e mundshme në këtë moment. Komuna, pra, do të prezantojë një sistem të klasifikimit të mbeturinave të riciklueshme.

Komuna do të identifikoj një vend brenda qytetit të Hanit të Elezit ku gjeneruesit e mbeturinave mund të sjellin mbeturinat e tyre të riciklueshme. Zona duhet të jetë mjaft e madhe për të lejuar akumulimin e pjesëve të mbeturinave të riciklueshme deri në atë masë sa është e mjaftueshme për të garantuar transportin për shitje jashtë komunës apo edhe për shitje jashtë Kosovës.

Për disa pjesë të riciklueshme, magazinimi do të bëhet i tillë që mbeturinat do të grumbullohen sipas elementeve. Ky rast më se shumti theksohet në mbeturinat e letres dhe kartonit, vlera e të cilave do të zvogëlohet ndjeshëm nëse ekspozohet ndaj reshjeve. Vendi që duhet të identifikohet, pra, do të përfshijë një ndërtesë të tipit depo apo do të jetë e pajisur me kontejnerë (për transportin e mallrave) për të ruajtur pjesët e mbeturinave të riciklueshme.

Në mënyrë që të motivohen gjeneruesit e mbeturinave që t'i sjellin mbeturinat e tyre në vendin e riciklimit, Komuna ka ndërmend të paguajë materialin e pastër të riciklueshme që dorëzohet. Çmimet që do të paguhet do të varen nga çmimet e tregut të cilat do të hulumtohen para vendosjes së sistemit të klasifikimit.

Vendi i mbeturinave të riciklueshme do të menaxhohet nga e njëjta kompani që do të ofroj shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Nga kompania do të kërkohet të mbaj një administrim të detajuar të sasive të mbeturinave të pranuar dhe pagesave të bëra dhe të raportojë tek Komuna në baza mujore.

Përveç riciklimit, Komuna do të mbështet gjenerimin e energjisë nga mbeturinat. Në këtë drejtim Komuna do të mbështesë aktivitetet e fabrikës së çimentos Sharrcem për të ndërtuar një pilot fabrikë për prodhimin e karburantit nga mbeturinat (refuse derived fuel - RDF) në stacionin e transferimit të Ferizajt. Komuna në mënyrë aktive do të ndjek zhvillimet dhe do të lidhet me iniciativën aty ku është e realizueshme dhe e dobishme.

3.4 Eliminimi i deponive të paligjshme të mbeturinave

Eliminimi i deponive të paligjshme do të ketë vëmendjen e vazhdueshme të Komunës si dhe veprimet për eliminim do të merret në baza ditore. Veprimet e kufizuara do të ndërmerren, për aq kohë sa të arrihet 100% e mbulimit të grumbullimit të mbeturinave, gjeneruesit e mbeturinave do të vazhdojnë të përdorin vendndodhjen e deponive të paligjshme dhe deponite e paligjshme do të ri-shfaqen pas eliminimit. Operacione të shumta të pastrimit duhet të presin derisa shërbimet e grumbullimit të mbeturinave ofrohet për të gjithë gjeneratorët e mbeturinave. Vetëm në këtë rast ri-shfaqja e deponive ilegale mund të parandalohen. Megjithatë, me përpjekje të vazhdueshme, fushata të ndërgjegjësimit publik dhe zgjerimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, të gjitha deponitë e paligjshme do të eliminohen deri në vitin 2017.

Mbeturinat e Komunës nga deponitë ilegale do të largohen sa më shumë që të jetë e mundur. Megjithatë, Komuna ka burime të kufizuara dhe mbulimi i mbeturinave me dhe, copëza dhe mbeturina nga ndërtimi dhe rrënojat të gjetura në afërsi të vendit do të duhet të jetë rehabilitimi si metodë e zgjedhjes në shumicën e vendeve. Kjo e fundit do të jetë veçanërisht rasti për lokacionet ku mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi janë deponuar në mënyrë ilegale. Lokacione të tilla mund të gjenden jashtë disa fshatrave të komunës.

3.5 Menaxhimi i mbeturinave të ndërtimit

Komuna e Hanit të Elezit ka për qëllim të përmirësoj pamjen e saj dhe të mbush disa nga gropat ekzistuese të erozionit dhe gropave natyrore në mënyrë që të zgjeroj fushën e tokës së shfrytëzueshme. Vendet që duhet plotësuar do të përcaktohen si vende për tu mbushur siç është cekur në nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr 7/5 për mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi. Kjo nënkupton se vetëm ndërtimet e pastra, inerte dhe mbeturinat nga rrënimi mund të deponohen. Materiali i ndotur do të trajtohet në një deponi në këtë mënyrë do të mblidhet nga kompania e menaxhimit të mbeturinave ose të transportohet tek deponia jashtë komunës nga gjeneruesit e mbeturinave.

Menaxhimi i deponive do të jetë i kufizuar në formësimin dhe grumbullimin e rastit të mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi të deponuara dhe formimin përfundimtar të deponive në përgatitje për përdorimin e vendit për qëllimin e caktuar (duke qenë një park në vend të deponisë aktuale). Për këtë menaxhim të vendit, komuna do të angazhojë një kontraktues privat. Realizimi i parkut në lokacionin aktual nuk është pjesë e menaxhimit të vendit dhe do të trajtohet në dokumente të tjera të planifikimit komunal.

Në pikëpamje të sasive të kufizuara të mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi që është gjeneruar në komunë, vetëm një deponi do të lejohet të jetë operative në një kohë. Vetëm pasi të përfundoj mbushja e deponisë aktuale, atëherë do të përcaktohet një deponi e re. Në mënyrë që kjo të zbatohet plotësisht, mbyllja dhe rehabilitimi i deponimeve ilegale të përdorura për mbeturina nga ndërtimi dhe demolimi do të jetë e nevojshme (shih nenin 3.4).

3.6 Pastrimi i rrugëve

Për të përmirësuar pastërtinë e rrugëve dhe vendeve publike, komuna do të ndajë fonde në kuadër të buxhetit komunal për të lejuar kompaninë private të angazhoj dy punëtorë shtesë për të kryer pastrimin e rrugë në mënyrë të përhershme. Mundësia për të përdorur pajisjet mekanike për pastrimin e rrugëve, në një fazë të mëvonshme, do të hetohen.

IV. Financimi i menaxhimit të mbeturinave

4.1 Tarifat e mbeturinave

Sipas rastit, Kuvendi Komunal në të ardhmen do të përcaktojë tarifën që do të paguhet për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Komuna do t'i bazojë tarifën në parimin e pagesës nga ndotësit sipas të cilit të gjithë gjeneruesit e mbeturinave do të duhet të paguajnë për mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave që ata krijojnë. Megjithatë, për të pasur tarifën të volitshme, një formë e subvencionimit është dhe do të inkorporohet në sistemin e tarifës. Bizneset e mëdha, të cilët përdorin kontejner të mbeturinave prej 1100 litra, do të duhet të paguajnë një tarifë pak më të lartë për njësi (vëllim) të mbeturinave të krijuara, krahasuar me ato të amvisërisë.

Ashtu si është përmendur në seksionin 1.1.5 tarifat aktuale janë:

- Amvisëritë të cilat përdorin një kontejner 120 litra: 3.00 € në muaj
- Bizneset paguajnë një tarifë që shkon nga 5.00 € deri në 15.00 € në muaj
- Bizneset e mëdha të cilat përdorin kontejner 1100 litra paguajnë 12 € për zbrazjen e kontejnerëve ose rreth 50 € në muaj në rastin kur mbeturinat mblidhen një herë në javë apo 100 € në muaj kur mbeturinat mblidhen dy herë në javë.

Komuna ka për qëllim mbajtjen e tarifave sa më të ulëta që të jetë e mundur dhe nuk dëshiron t'i rrisë tarifën aktuale gjatë periudhës së planifikimit deri në 2019. Megjithatë, të ardhurat totale nga tarifën e grumbullimit të mbeturinave do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e përgjithshme të ofrimit të mbledhjes së mbeturinave dhe shërbimit të pastrimit të rrugëve. Për të qenë në gjendje për të mbajtur tarifën në nivelin e tyre aktual, efikasiteti i mbledhjes së tarifës do të duhet të përmirësohet. Nga viti 2015 e më tej, tarifën nuk do të mblidhen nga kompania e menaxhimit të mbeturinave, por nga komuna. Në të njëjtin vit, shkalla e tarifës së mbledhjes do të rritet në 70%.

Të gjitha tarifën do të paguhet në komunë, ndërsa komuna do të paguajë kontraktuesit për shërbimet e saj. Për të qenë në gjendje për të paguar kontraktuesin në mënyrë të plotë dhe në kohë, shkalla e mbledhjes së tarifave do të jetë rreth 90%. Kjo i ofron komunës mundësinë për të mbështetur ata që nuk mund të përballojnë për të paguar tarifën e tyre në mënyrë të plotë. Ata që jetojnë në varfëri do të lejohen të paguajnë një shkallë të tarifës së reduktuar, niveli i së cilës do të përcaktohet nga Kuvendi Komunal.

Në mënyrë që të sigurohen të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, do të aplikohet një metodë pro-aktive e mbledhjes së tarifës si dhe sanksionet për mos pagesë. Gjeneruesve të mbeturinave do t'u kërkohej që të paguajnë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave në zyrat komunale, por ata që nuk e bëjnë këtë do të vizitohen në vendin e tyre të banimit ose vendin e biznesit. Në këto raste, një kosto e tarifës për mbledhje prej 10% të tarifës së mbeturinave do t'i shtohet tarifës së mbledhjes së mbeturinave, edhe pse fillimisht kjo shtesë pagesë për tarifë nuk do të aplikohet dhe shpenzimet e mbledhjes parapagimi do të mbulohen nga buxheti për promovimin e pagesave dhe shfrytëzimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave (referohuni planit të veprimtimit).

Për hudhjen e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi në lokacione për mbushje, një tarifë do të futet. Tarifa do të përcaktohet nga KK, por këtu një tarifë tentative nga 3.00 € për ton është përmendur.

4.2 Mbështetja nga buxheti komunal

Komuna do të ndajë fonde për mbledhjen e mbeturinave nga objektet e saj, si dhe nga shkollat, klinikat dhe stacionin e zjarrfikësve. Përveç kësaj, do të ndahen fonde për përmirësimin e vazhdueshëm të pastrimit të rrugëve, pastrimin e planifikuar të deponive ilegale dhe largimin e mbeturinave të hedhura në mënyrë të paligjshme të mbeturinave nga gjeneruesi apo pronari i të cilave nuk mund të vërtetohet. Në rast se gjeneruesi i mbeturinave ose pronari i mbeturinave të hedhura në mënyrë të paligjshme mund të vërtetohet, atëherë komuna do të rikuperojë shpenzimet nga gjeneruesi ose pronari i mbeturinave.

Komuna do të ndajë fonde për aktivitetet e ndërgjegjësimit publik dhe trajnimin e stafit të tyre siç përshkruhet në kapitullin në vijim të këtij plani.

Të ardhurat vetanake të krijuara në Hanin e Elezit do të përdoret për investimet kapitale duke përfshirë dhe prokurimin e automjetit të mblledhjes së mbeturinave.

V. Masat mbështetëse

5.1 Ngritja e vetëdijes së publikut

Komuna e konsideron ngritjen e vetëdijes si një aktivitet kyç për të siguruar zbatimin e suksesshëm të këtij plani të menaxhimit të mbeturinave. Megjithatë, komuna gjithashtu kupton se një fushatë e ndërgjegjësimit publik mund të arrijë rezultatet e synuara vetëm nëse fushata e tillë shoqërohet me aktivitete në terren. Për këtë arsye, aktivitetet e vetëdijes së publikut do të ndërmerren së bashku me përmirësimin e lokacionit të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave. Aktivitetet e vetëdijes për shembull, do të kryhen së bashku me zgjerimin e mbledhjes së mbeturinave në fshatrat që aktualisht nuk e gëzojnë një shërbim të tillë.

Një fushatë për të rritur efikasitetin e tarifës së mbledhjes do të fillojë atëherë kur komuna merr përsipër grumbullimin aktual tarifor nga kompania e menaxhimit të mbeturinave. Informacioni do të shpërndahet me anë të një letre informuese me anë të së cilës informon të gjithë gjeneruesit e mbeturinave, si bizneset ashtu dhe amvisëritë, në lidhje me ndryshimet që do të zbatohen dhe pasojat e mos-pagesës. Në mënyrë që të rrit dhe të ruaj gatishmërinë për të paguar në mesin e gjeneruesve të mbeturinave, financimi i shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave do të bëhet sa më transparent të jetë e mundur dhe, si pjesë e ngritjes së vetëdijes publike, komuna do të publikoj kostot dhe të ardhurat që lidhen me sigurimin e shërbimit publik të menaxhimit të mbeturinave. Të paktën një herë në vit komuna do të publikojë një raport financiar të detajuar për shpenzimet dhe të ardhurat.

Qëllimi i komunës është që të synoj të rinjtë me anë të një programi arsimor të detyrueshëm shkollor për mjedisin. Pasi që dihet se komuna ka mungesë të kapaciteteve për të zhvilluar një program të tillë, do të kërkoj këshilla nga MMPH-ja³ dhe Ministria e Arsimit. Të dy ministrive do tu drejtohet kërkesa për të identifikuar programe të përshtatshme ekzistuese brenda Kosovës apo jashtë vendit dhe për t'i siguruar komunës informacionet dhe asistencën e nevojshme për të filluar programin shkollor prej vitit të ardhshëm shkollor, në shtator të vitit 2014. Programi shkollor do ofrojë arsim të përgjithshëm mjedisor, në të cilin mbeturinat dhe menaxhimi i tyre do të trajtohen si çështje lokale shumë të rëndësishme

5.2 Programet e trajnimit

Komuna e njej nevojën për zhvillimin e ekspertizës dhe aftësive në menaxhimin e mbeturinave në mesin e stafit komunal. Gjithashtu, inspektorët mjedisor duhet të zhvillojnë kapacitetet për të mbledhur prova kundër shkelësve dhe të nisin rastin kundër tyre në mënyrë të tillë që të mund të arrihet një ndjekje penale e suksesshme në gjykatë. Prandaj komuna do të nxis stafin që të identifikojnë seminare dhe trajnime të lidhura me menaxhimin e mbeturinave që do të organizohen në Kosovë ose në Ballkan. Seminare dhe trajnime të tilla mund të përfshijnë trajnime të organizuara nga MMPH-ja siç parashihet në Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbeturinave.

Anëtarët e stafit të përfshirë direkt në menaxhimin e mbeturinave, qoftë në planifikimin e menaxhimit të mbeturinave ose në mbikëqyrjen e menaxhimit të mbeturinave, do të lejohen dhe do të nxiten që të marrin pjesë në seminare dhe trajnime deri në 10 ditë pune për çdo vit, ndërsa anëtarët e stafit të përfshirë indirekt në menaxhimin e mbeturinave si anëtarët e grupit punues për menaxhimin e mbeturinave do të lejohen të marrin pjesë në seminare deri në 5 ditë pune çdo vit. Shpenzimet e pjesëmarrjes dhe të udhëtimit në këto seminare dhe trajnime do të mbulohen nga buxheti komunal. Në rast se donatorët financojnë pjesëmarrjen në trajnim, kufizimi prej 10 dhe 5 ditë të punës nuk zbatohet dhe mund të përcillen edhe trajnime jashtë Ballkanit.

³ Zhvillimi i një programi arsimor është parashikuar në Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbeturinave.

VI. Rregulloret dhe zbatimi

6.1 Rishikimi i rregulloreve të menaxhimit të mbeturinave

Dispozitat që rregullojnë menaxhimin e mbeturinave në Hanin e Elezit janë të përfshira në Rregulloren për Mbrojtjen e Mjedisit të vitit 2006, të cilat janë miratuar nga Kuvendi Komunal (KK).

Rregullorja aktuale për mbrojtjen e mjedisit nuk përfshin detyrimin e gjeneruesve të mbeturinave për të paguar për shërbimin e mbledhjes dhe asgjësimit të mbeturinave. Për këtë arsye Komuna do të rishikojë në mënyrë kritike rregulloren aktual dhe do të propozojë te KK për përfshijën e detyrimit e gjeneruesve të mbeturinave për të paguar tarifën e cila do të vendoset nga KK-ja dhe rishikuar në baza vjetore. Ajo do të propozon se mos-pagesa e taksës do të dënohet me gjobë.

Propozimi do të hartohet si një rishikim i Rregullorës për mbrojtjen e mjedisit dhe të dorëzohen në KK për miratim në vitin 2014.

6.2 Zbatimi

Pas miratimit të rishikimit, komuna do të fillojë zbatimin e dispozitave të menaxhimit të mbeturinave në rregulloren për mbrojtjen e mjedisit, si dhe të Ligjit për mbeturina. Theksi i zbatimit do të vendoset në pagesën e tarifës për menaxhimin e mbeturinave. Ata që i shmangen pagesës do të identifikohen duke krahasuar regjistrin e amvisërive dhe regjistrin e biznesit me faturën e lëshuar për pagesën e tarifës së menaxhimit të mbeturinave. Ata që nuk paguajnë do të vizitohen nga një inkasant i tarifave i cili në radhë të parë do të mbledhë vetëm tarifën dhe do të ofroj informata për shkaqet dhe nevojën e pagesës së tarifës për menaxhimin e mbeturinave. Në rast të shmangies së zgjatur të pagesës dhe në rast të përsëritjes së shkeljes, inspektori përgjegjës për mjedisin do të shoqërojë inkasantin e tarifave dhe do të vendosë një gjobë mbi tarifën për grumbullimin e mbeturinave. Në një fazë të mëvonshme dhe një tarifë shtesë të mbledhjes së mbeturinave do të futet.

Përveç kësaj aktivitetet e zbatimit do të synojnë parandalimin e largimit të paligjshëm të mbeturinave në komunë dhe rikuperimin e kostove të largimit të mbeturinave të paligjshme të deponuara nga kundërvajtësit. Nëse kërkohet, shkelësit do të merren në gjykatë. Megjithatë, aktivitetet e zbatimit do të kryhen vetëm në zonat e komunës, ku ofrohen shërbimet e mbledhjes së mbeturinave. Aktivitetet e zbatimit në fshatrat ku mbeturinat aktualisht nuk mblidhen do të nisin vetëm pas futjes së shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave dhe kryerjen e një fushate të ndërgjegjësimit publik. Përpara nisjes së mbledhjes së mbeturinave, gjeneruesit e mbeturinave do të inkurajohen që të transferojnë mbeturinat e tyre në një kontejner publik në qytetin e Hanit të Elezit.

Shtojca I. Anëtarët e Grupit Punues për Përgatitjen e Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave

- Mendu Vlashi, Zëvendës Kryetar i Komunës
- Refet Kalisi, Drejtor i Shërbimeve Publike
- Sevime Laqi, Drejtoresh e Zhvillimit Ekonomik
- Muzafer Dernjani, Drejtoresh e Shëndetësisë
- Kujtim Dernjani, Shef i Sektorit të Shërbimeve Publike
- Fatbardha Bushi, Zyrtare e Mjedisit
- Bajrush Laqi, Zyrtar Ligjor
- Xhemshit Kalisi, Zyrtar
- Besnik Reçi, Zyrtar

Këshilltarët,

- Jan Tesink, Ekspert për Menaxhimin e Mbeturinave
- Doruntinë Rexhepi, Zyrtare e Mjedisit
- Sami Stagova, Planer

Shtojca II. Plani i Veprimit

Synimi 1: Përmirësimi i shërbimit të mbledhjes së mbeturinave në të gjithë komunën Hanit të Elezit			
Rezultati i dëshiruar: Mbledhja e mbeturinave 100% nga gjeneruesit e mbeturinave deri në fund të vitit 2015			
<i>Veprimet / hapat / Projektet</i>	<i>Ndarja e përgjegjësisë</i>	<i>Afati kohor dhe shpenzimet (€)</i>	<i>Financuar nga</i>
Përgatitja e dokumenteve të tenderit për automjetin e ri apo të rinovuar të grumbullimit të mbeturinave prej 12 deri në 14 m ³ (12 ton)	Komuna	Tremujori i katërt 2014	
Përpilimi i planit të biznesit dhe për kompaninë e menaxhimit të mbeturinave publike në pronësi të komunës dhe kërkesën për miratim nga qeveria qendrore për të krijuar kompaninë e tillë	Komuna/Specialist të jashtëm	Tremujori i katërt 2014; dorëzimi i aplikacionit Janar –Shkurt 2015 (€ 500 deri € 1,000)	Komuna
Blerja (Prokurimi) i automjetit të grumbullimit të mbeturinave	Komuna	Tremujori i parë 2015 (80,000. € -)	Komuna, donatori
Themelimi i kompanisë komunale ose (në rast të përgjigjes negative nga qeveria qendrore) përzgjedhjen e kompanisë private për të vepruar me automjetet për grumbullimin e mbeturinave	Komuna	Mars 2015	
Përfundimi i kontratës në mes të Komunës dhe kompanisë për menaxhimin të mbeturinave	Komuna dhe Kompania e menaxhimit të mbeturinave	Mars 2015	
Nisja e përmirësimit të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave dhe informimi i banorëve dhe bizneseve për shërbimet e përmirësuara me një letër informuese dhe / ose broshurë	Kompania komunale ose private; komuna	Mars-Prill 2015 (250€)	Buxheti komunal
Promovimi i pagesës dhe shfrytëzimit të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave	Komuna përmes letrave informuese, broshurave, takime dhe vizita me jo-paguesit	Prej marsit 2015 e në vazhdim (2,000€ /vit)	Buxheti komunal
Monitorimi, informimi dhe raportimi	Grupi punues, inspektori përgjegjës për mjedisin,	Vazhdimisht	

	kompania e menaxhimit të mbeturinave		
Vlerësimi i shërbimit	Komisioni mbikëqyrës	Dy herë në vit	

Synimi 2: Promovimi i kompostimit

Rezultati i dëshiruar: Së paku dhjetë amvisëri në qytetin e Hanit të Elezit të kompostojnë mbeturinat organike që ata gjenerojnë deri në vitin 2016, studimi i fizibilitetit për kompostim të centralizuar të realizohet deri në vitin 2017

<i>Veprimet / hapat / Projektet</i>	<i>Ndarja e përgjegjësi</i>	<i>Afati kohor dhe shpenzimet (€)</i>	<i>Financuar nga</i>
Konsultimet me kryesuesit e fshatrave dhe identifikimi i individëve të gatshëm për të filluar kompostimin e mbeturinave të tyre organike	Grupi punues, kryesuesit e fshatrave, zyrtarët për marrëdhënie me publikun	Maj – Korrik 2015	
Mbledhja dhe shtypja e informacionit për kompostim	Komuna	Deri në qershor 2015 (€ 150)	Buxheti komunal
Prokurimi i materialeve për ndërtimin e kontejnerve të plehrave dhe/ose prokurimi i kontejnerve komerciale të gatshëm të kompostimit të plehrave	Komuna	Mars 2016 (€ 750)	Komuna ose donatori
Montimi i kontejnerve për kompostim dhe fillimi i kompostimit	Individët me mbështetjen e stafit komunal	Prill 2016	
Takimet e rregullta të individëve që ushtrojnë kompostimin	Individët, Komuna dhe OJQ-të	Çdo muaj nga marsi deri në shtator 2016	
Monitorimi, informimi dhe raportimi	Grupi punues, inspektori përgjegjës për mjedisin	Çdo dy muaj nga marsi i vitit 2016 e tutje	
Studimi i fizibilitetit i kompostimit të centralizuar nga kompania e menaxhimit të mbeturinave	Kompania e menaxhimit të mbeturinave; Komuna; ekspert të jashtëm	Tremujori i katërt 2016 (€ 500- € 1,000)	Komuna ose donatori
Identifikimi i lokacioneve të mundshme për kompostimin e centralizuar	Komuna; ekspert të jashtëm	Tremujori i parë 2017 (e përfshier në studimin e fizibilitetit)	
Përgatitja e vendit për kompostimin e centralizuar	Komuna; sektori privat	Për tu përcaktuar	Për tu përcaktuar
Nisja e grumbullimit të pjesës organike të	Kompania e menaxhimit të mbeturinave	Për tu përcaktuar	Për tu përcaktuar

mbeturinave nga tregu, sipërfaqeve të gjelbra dhe gjeneruesit vullnetarë të mbeturinave; nisja e kompostimit të centralizuar			
--	--	--	--

Synimi 3: Prezantimi i riciklimit

Rezultati i dëshiruar: Klasifikimi i kategorizuar për pjesët e mbeturinave të riciklueshme janë prezantuar me sukses

<i>Veprimet / hapat / Projektet</i>	<i>Ndarja e përgjegjëse</i>	<i>Afati kohor dhe shpenzimet (€)</i>	<i>Financuar nga</i>
Përzgjedhja e vendndodhjes për mbledhjen dhe grumbullimin e pjesëve të riciklueshme, letrës dhe kartonit, metalet duke përfshirë kanaçet metalike dhe plastike	Komuna	Nëntor 2014	
Studimi i tregut për kërkesën dhe çmimet e pjesëve të mbeturinave të riciklueshme; luhatshmëria e çmimeve	Komuna, eksperti i jashtëm	Tetor – Dhjetor 2014 (€500 - 4,000€)	Komuna ose donatori
Prokurimi i kontejnerëve	Komuna	Janar 2015 (7,000€)	Komuna ose donatori
Përgatitja e materialeve informuese: shenjat në afërsi të kontejnerëve, afishet në kontejnerë dhe broshurat	Komuna	Shkurt 2015 (500€)	Komuna
Përgatitja e lokacionit, vendosja e shenjave dhe kontejnerëve	Komuna, kontraktuesi	Mars 2015 (300€)	Komuna
Ngjarje zyrtare për vendosjen e kontejnerëve në përdorim	Komuna, gazetarët	Mars 2015	
Rregullimi i transportit dhe shitjes së pjesëve të riciklueshme	Kompania e menaxhimit të mbeturinave	Çdo muaj ose tremujor prej tremujorit të dytë 2015 e në vazhdim	
Monitorimi dhe vlerësimi	Grupi punues, inspektori përgjegjës për mjedisin; zyrtar/e i/e financave	Çdo dy muaj nga marsi i vitit 2015 e në vazhdim	

Përmirësimi i zonës së riciklimit, për shembull nëpërmjet shtypjes, pastrimit dhe grisjes së materieve plastike	Komuna	Të përcaktohet në bazë të monitorimit dhe vlerësimit	Kompania e menaxhimit të mbeturinave (të ardhurat nga shitja e pjesëve të riciklueshme)
---	--------	--	---

Synimi 4: Eliminimi i deponive të paligjshme

Rezultati i dëshiruar: Të gjitha deponitë e paligjshme të eliminohen deri në vitin 2017

<i>Veprimet / hapat / Projektet</i>	<i>Ndarja e përgjegjëse</i>	<i>Afati kohor dhe shpenzimet (€)</i>	<i>Financuar nga</i>
Anketa e të gjitha deponive ilegale, përgatitja e hartave dhe vlerësimi i detajuar i shumave të mbeturinave	Komuna (Departamenti i Gjeodezisë)	Mars-korrik 2016	
Përpilimi i dokumenteve të tenderit për përzgjedhjen e një kompanie private për rehabilitimin e deponive të paligjshme	Komuna	Gusht 2016	
zgjedhja e kontraktuesit	Komuna	Shtator 2016	
Fillimi i punimeve rehabilituese të shënuara me ngjarje publike	Komuna, kontraktuesi, gazetarët	Shtator /Tetor 2016	
Kryerja e punëve	Kontraktuesi	Tetor 2016 deri në fund të 2017 (€ 25,000 - € 30,000)	Komuna, Qeveria plus donatori
Mbikëqyrja, monitorimi dhe vlerësimi	Inspektori për mjedisin dhe inspektori për punët civile	Tetor 2016 deri fund të 2017	

Synimi 5: Përdorimi i mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit

Rezultati i dëshiruar: Mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit përdoren

<i>Veprimet / hapat / Projektet</i>	<i>Ndarja e përgjegjëse</i>	<i>Afati kohor dhe shpenzimet (€)</i>	<i>Financuar nga</i>
Përdorimi i mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit	Kontraktuesit rrugor (ndër të tjerë)	Nga korrik 2014 e tutje	

Formësimi i vendit të ndërtimit dhe rrënimit dhe punët për të mbajtur deponinë në gatishmëri	Kompania private që do të kontraktohet nga komuna	Nga korriku 2014 deri në fund të 2019: tremujor (€ 4,000 në vit)	Buxheti komunal (në fund të fundit nga tarifa e mbeturinave nga N&D)
Mbyllja e lokacionit aktual për mbushjen dhe përgatitjen e vendit për realizimin e një parku (realizimi i parkut nuk përfshihet)	Komuna	Mes 2016 (€ 10,000)	Komuna (pjesërisht nga tarifa e mbeturinave nga N&D)
Identifikimi i lokacionit të ri për përdorimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënim (në Gorance)	Komuna	Korrik 2016	
Informimi i gjeneruesëve për përcaktimin e vendit të ri të mbeturinave	Komuna përmes takimit me të gjithë gjeneruesit e mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënim	Korrik 2016	
Monitorimi dhe vlerësimi	Inspektorët	Nga korriku i vitit 2014 e tutje	

Synimi 6: Përmirësimi i vazhdueshëm i pastrimit të rrugëve

Rezultati i dëshiruar: Pastërtia e rrugëve dhe hapësirave publike është përmirësuar

<i>Veprimet / hapat / Projektet</i>	<i>Ndarja e përgjegjësi</i>	<i>Afati kohor dhe shpenzimet (€)</i>	<i>Financuar nga</i>
Ndarja e fondeve për pastrimin e rrugëve dhe ndryshimi i kontratës me kompaninë e menaxhimit të mbeturinave për të angazhuar dy pastrues të rrugëve shtesë	Komuna	Janar 2015	
Aktivitetet e përmirësuar në pastrimin e rrugëve	Kompania e menaxhimit të mbeturinave	Nga janari 2015 e tutje (6,000 në vit)	Buxheti komunal
Hetimi i mundësive për të përdorur pajisjet mekanike për pastrimin e rrugëve	Komuna	Janar-mars 2016	
Monitorimi dhe vlerësimi	Inspektorët	Nga janari 2015 e tutje	

Përmbledhje e kostos në vit për secilin aktivitet

	Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Total
Objektivat								
1 Përmirësimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave		€ 1,000	€ 82,250 *)	€ 2,000	€ 2,000	€ 2,000	€ 2,000	€ 91,250
2 Promovimi i kompostimit			€ 150	€ 1,750				€ 1,900
3 Prezantimi i riciklimit		€ 1,000	€ 7,800					€ 8,800
4 Pastrimi i deponive ilegale				€ 15,000 **)	€ 15,000 **)			€ 30,000
5 Përdorimi i mbeturinave N&D		€ 2,000	€ 4,000	€ 14,000	€ 4,000	€ 4,000	€ 4,000	€ 32,000 ***)
6 Përmirësimi i vazhdueshëm i pastrimi i rrugëve			€ 6,000	€ 6,000	€ 6,000	€ 6,000	€ 6,000	€ 30,000
Totalet		€ 4,000	€ 100,200	€ 38,750	€ 27,000	€ 12,000	€ 12,000	€ 193,950

Kosto të mbulohet nga buxheti komunal me përjashtimet e mëposhtme

**) Kontributi i donatorëve të parashikuara*

****) Kontributet nga qeveria qendrore dhe donatorëve të parashikuara*

*****) Në pjesën e mbuluar nga tarifa nga mbeturinat N&D*

Shtojca III. Të dhënat për mbeturinat e Sharrcem-it

Gjenerimi i mbeturive 2013

Lloji i mbeturive	Kodi i mbeturive *)	Kodi i mbeturive **)	Sasia e mbeturive
Mbeturive të brendshme të përziera	200108	200301	35.6 ton
Hekurishte	160117	170405	308 ton
Tulla zjarrduruese	101308		330 ton
Thasët e çimentos		150101	4.2 ton
Mbeturina të paketimit plastik	150102		1.9 ton
Mbeturina nga rrënimi	885032	170101	885 ton
Paleta druri	150103		81 ton

Shfrytëzimi i mbeturive 2013

Lloji i mbeturive	Kodi i mbeturive *)	Kodi i mbeturive **)	Sasia e mbeturive
Hi në ajër	100102		95,316 ton
Hi në sipërfaqe		100101	15,281 ton
Hi pirit		??	7,154 ton
Tulla zjarrduruese	101308		50 ton

*) kodi i mbeturive të ofruara nga Sharrcemi

***) kodi i mbeturive nga eksperti i menaxhimit të mbeturive

